

Njoftim për kryerjen e inspektimit në institucionin e Këshillit të Qarkut Berat

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me Urdhrin e Brendshëm nr. 79, (nr. 551 prot.), datë 21.04.2026, *“Për kryerjen e inspektimit, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procedurës së ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, në institucionin e Këshillit të Qarkut Berat”*, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në zbatim të planit vjetor të punës, ka nisur inspektimin për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën *“Korrik-Dhjetor 2025”*, të nëpunësve civilë në institucionin e Këshillit të Qarkut Berat.

Ky proces është përmbyllur me vendimin paralajmëruar nr. 64, datë 16.06.2026, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Mbi verifikimin e ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në institucionin e Këshillit të Qarkut Berat dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, në të cilin janë lënë detyra konkrete për zyrtarët e ngarkuar nga ligji me detyra specifike gjatë këtij procesi, me qëllim rikthimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

